REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 01.08.2024 | Nr: 155 | Ora: 15:36

# VENDIM

## PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË "MEDIA VIZION SH.A", PËR AKREDITIMIN E VËZHGUESVE PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË TË DATËS 4 GUSHT 2024

Sot në datën 01.08.2024, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën e:

**KËRKUES:** "MEDIA VIZION SH.A", me adresë në RRUGA :DON BOSKO NR .5 TIRANE;

**OBJEKTI:** Kërkohet akreditimi si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve te pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë". Vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave".

## V Ë R E J:

"MEDIA VIZION SH.A" i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 2 vëzhguesve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre.

Kërkesa është paraqitur në datën 01.08.2024.

"MEDIA VIZION SH.A", në respektim të nenit 6, pika 2 të Kodit Zgjedhor është një organizatë që gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje.

Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor.

Dokumentacioni shoqërues i kërkesës është në përputhje me përcaktimet e nenit 6, pika 4 e vijues të Kodit Zgjedhor

## PËR KËTO ARSYE:

Si dhe në mbështetje të neneve 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave",

## V E N D O S :

1. Akreditimin e 2 vëzhguesve të "MEDIA VIZION SH.A" për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 1 (një) dite nga shpallja e tij në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Aneksi 1: Lista e Vëzhguesve te Miratuar te “MEDIA VIZION SH.A”

| | Emri | Mbiemri | Mandati | Seriali | Zona e vezhgimit |
|---|---|---|---|---|---|
| **1.** | Jonel | Lasku | Afatshkurter | 000087 | Vlorë |
| **2.** | Enkelejda | Mema | Afatshkurter | 000088 | Vlorë |